



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 46/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të mbajtjes së fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale për kryetar komune në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 20.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

Me datë 19.04.2012, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV dega në Ferizaj, më të cilën theksohet se me 17 Prill 2012, kryeministri dhe njëkohësisht kryetari i subjektit politik PDK Hashim Thaçi ka qëndruar në komunën e Shtimes duke u bërë thirrje qytetarëve të kësaj komune që të ndikojnë tek banorët e Ferizajt duke shfrytëzuar lidhjet familjare dhe kolegjiale të tyre për të fituar kandidati i këtij subjekti politik Agim Aliu. Sipas kësaj, parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik PDK ka bërë shkelje të LZP-së dhe Kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, pasi që pika 1 e nenit 64 të LZP-së e bënë KQZ-në përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, pasi që KQZ-ja, ka nxjerrë një vendim se fushata zgjedhore në Ferizaj fillon me 23 Prill 2012 dhe në nenin 7 të këtij vendimi specifikon se fushata zgjedhore për komunën e Ferizajt do të zgjasë 5 ditë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë foton e kryeministrit si dhe fjalimin e tij para qytetarëve të kësaj komune.

Neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Duke u mbështetur dispozitat e parapara ligjore të LZP-së dhe Rregullat Zgjedhore të cilat përcaktojnë të drejtat e subjekteve politike si dhe veprimet e ndaluara të tyre vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe meqenëse veprimet e pretenduara janë zhvilluar para datës së përcaktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, si dhe duke u bazuar në atë se me asnjë dispozitë të LZP-së dhe as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ndëshkimore ligjore për mbajtjen e fushatës zgjedhore para datës së përcaktuar për mbajtjen e saj.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 46/2012 më datën 20.04.2012.

